

**VENDIM**  
**Nr. 527 , datë 25.7.2019**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËRORE TË SISTEMIT  
INFORMATIK TË MENAXHIMIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e bazës së të dhënave shetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar (SIMF).

2. SIMF-i përbëhet nga modulet, si më poshtë vijon:

2.1 Moduli i përgatitjes dhe monitorimit të programit buxhetor afatmesëm;

2.2 Moduli i menaxhimit të investimeve publike;

2.3 Moduli i monitorimit të portofolit të projekteve;

2.4 Arkivi elektronik për arkivimin e dokumentacionit mbështetës të transaksioneve buxhetore.

3. SIMF-i ndërvepron me:

3.1 Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;

3.2 Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), në administrim funksional të njësisë përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri;

3.3 Sistemin Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat.

4. SIMF-i përmban të dhëna që ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat që gjenerohen në SIMF për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit të njësive të qeverisjes qendrore, specififikisht, si më poshtë:

4.1.1 Të dhëna për tavanet buxhetore në nivel njësie të qeverisjes qendrore dhe programi buxhetor;

4.1.2 Emërtimet dhe kodet e programeve buxhetore;

4.1.3 Të dhënat për projektet e investimeve publike;

4.1.4 Të dhënat për produktet, sasitë dhe kostot përkatëse;

4.1.5 Të dhënat për treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektiv;

4.1.6 Emërtimi dhe kodet e produkteve e të projekteve të investimeve publike;

4.1.7 Të dhëna për raporte financiare menaxheriale, monitoruese dhe statistikore.

4.2 Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që kanë referencë dhe merren nga:

4.2.1 SIFQ:

a) Emërtimi dhe kodet e njësive të qeverisjes së përgjithshme sipas SIFQ-it;

b) Klasifikimi buxhetor, në përputhje me ligjin organik të buxhetit, nr.9936/2008, të ndryshuar, dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij;

c) Të dhëna për buxhetin faktik të njësive të qeverisjes së përgjithshme në nivel projekti, produkti, angazhimeve buxhetore dhe artikulli ekonomik.

4.2.2 SIPI/IPSIS:

a) Versioni i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) Të dhëna lidhur me qëllimin e politikave të programeve buxhetore;

c) Të dhëna lidhur me objektivat specifike të programeve buxhetore;

ç) Masat prioritare lidhur me programet zhvillimore dhe projektet kombëtare strategjike;

- d) Të dhëna për treguesit e performancës në nivel qëllimi;
- dh) Të dhëna për treguesit e performancës në nivel objektivi specifik.

#### 4.2.3 EAMIS:

a) Të dhëna për disbursimet e kryera nga donatorët për projektet e investimeve publike me financim të huaj.

5. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

6. Subjektet përgjegjëse të SIMF-it janë, si më poshtë vijon:

- a) Institucioni administrues i SIMF-it është ministria përgjegjëse për financat;
- b) Institucionet, palë të interesuara, janë: ministria përgjegjëse për financat, ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore qendrore.

7. Dhënës të informacionit janë njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIMF.

8. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SIMF-it është, si më poshtë vijon:

a) Administratorët e SIMF-it kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SIMF në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, klasifikimin buxhetor e kontabël dhe të subjekteve të regjistruara;

b) Ministritë e linjës kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në SIMF;

c) Ministria përgjegjëse për financat ka të drejta administrative mbi SIMF-in në këto role:

- i) Administrator;
- ii) Raportues;
- iii) Auditues;
- iv) Zhvillues.

9. Për një periudhë tranzitore prej jo më shumë se një vit kalendarik, që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, lejohet regjistrimi manual në SIMF i të dhënave lidhur me politikat dhe objektivat specifikë të programeve buxhetore deri në sinkronizimin e plotë automatik të të dhënave ndërmjet SIPI-t dhe SIMF-it.

10. Vendimi nr. 82, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit të Programit Buxhetor Afatmesëm”, shfuqizohet. Të dhënat e SPBA-së transferohen te SIMF-i brenda 6 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

11. Ngarkohet ministria përgjegjëse për financat dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**